REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 6377 Prot

Maliq, më 27.11.2025

VENDIM

Nr 142, datë 26.11.2025

"PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE, PLANIT TË AKTIVITETEVE, KONSULTIMEVE PUBLIKE DHE BUXHETIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË MALIQ PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2026"

Bazuar në ligjin nr.139/2015, *Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar ,neni 54, neni 55, pika a dhe neneve 8 pika 2, neni 9,pika 1, nënpika 1.1 gërma b), pika 2 e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq me propozim të Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1. Të miratojë Dokumentin e Politikave, Planin e aktiviteteve, Konsultimeve Publike dhe buxhetit të Këshillit Bashkisë Maliq për periudhën janar-dhjetor 2026 bashkangjitur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Këshillit dhe Sekretari i Këshillit.

3. Plani i aktiviteteve i nënshtrohet ndryshimeve të herëpasherëshme dhe përditësohet nga Sekretari i Këshillit.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015*"Për vetëqeverisjen vendore"* i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Buxheti vjetor 2026 i Këshillit të Bashkisë Maliq , në lekë

Tema	Lloji i Aktivitetit	Shpenzimet											
		Kancelari	Leter	Shtypshkrime	Karburant (shpenzime automjeti)	Qera salle	Shpenzime per foni	Shpenzime media	Njoftime ne media	Akomodim Transport	Boje printer/ fotokopje	Blerje të vogla (ujë, pije)	Totali i shpenzimeve
Aktiviteti normal i mbledhjeve të Këshillit	Shumëfishimi i materialeve	10,000	10,000								20,000		40,000
	Ekspertize per zhvillimin e turizmit ne Maliq												10,000
	Hartimi injë buletini informues për punën e Këshillit.			20,000									20,000
Degjesa publike	Dëgjesa publike sipas Planit të konsultimeve				50,000								50,000
	Të tjera												-
Trajnime të këshilltarëve, sekretarit të këshilli, pjesëmarrje në konferenca aktivitete dhe vizita studimore										500,000			500,000
Organizime aktivitetesh, ceremoni, ngjarje festive, pritje te delegacioneve nga Keshillat homologe	Ftesa për të ftuarit,kartolina			20,000								10,000	30,000
	Dite e hapur per qytetaret			30,000						30,000		10,000	70,000
Sistem elektronik votimi Aktivitete te Aleances te grave keshilltare	Blerje pajisjesh Tetori roze, 7-8 marsi(aktivitete sensibilizuese)												50,000
	Të tjera												-
TOTALI		10,000	10,000	70,000	50,000	-	-	-	-	530,000	20,000	20,000	700, 000

** Ne këtë buxhet nuk është përfshirë pagesa mujore e Këshilltarëve.*

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

PLAN I KONSULTIMEVE PUBLIKE TË KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ VITI 2026

Plani i konsuiltimeve është vlerësim paraprak i nevojave për konsultim publik. Ky plan do rishikohet dhe do përditësohet nga nevoja tpër konsultim që do vijnë nga projekt-vendimet të cilat do paraqiten për vendimarrje duke pare detyrimin ligjor për konsultim dhe nevojën e këshillit për të realizuar procesin e konsultimit publik.

Muaji Janar

1. Tërheqja e mendimit të qytetarve për përcaktimin e Tavaneve Buxhetore 2027-2029.(sondazh)

Muaji Shkurt

1. Inforamcion për prioritetet e publikut për Tavanevet përgatitore Buxhetore 2027-2029.

(Kryetari i këshillit, Sekretari i Këshillit)

2. Prezantimi i prioriteteve të qytetarve për Tavanevet përgatitore Buxhetore 2027-2029

Muaji Mars

1.Konsultime sipas nevojave te vendimmarrjes (rast pas rasti)

Muaji Prill

1.Konsultime sipas nevojave te vendimmarrjes (rast pas rasti)

Muaji Maj

1.Konsultime sipas nevojave te vendimmarrjes (rast pas rasti)

Muaji Qershor

1. Konsultim publik online për përcaktimin e prioriteteve të PBA 2027-2029 ne lidhje me programet buxhetore të bashkisë dhe investimet.

(Kryetari i këshillit, Sekretari i Këshillit)

Muaji Korrik

Nëse nevojiten, konsultime për çështje tematike.

Muaji Gusht

1. Hartimi i kalendarit te detajuar te konsultimeve te PBA '26-28 ne NJA, per muajt shtator, tetor dhe nentor 2026.

Muaji Shtator

Konsultime sipas nevojave te vendimmarrjes (rast pas rasti)

Muaji Tetor

1. Njoftimi i Konsultimit Publik për Paketën Fiskale 2027, Buxhetin 2027, PBA 2027-2029.

Muaji Nëntor

1. Realizimi i takimeve konsultative me banorë dhe grupet e interesit për buxhetin 2027 dhe Paktën Fsikale 2027, PBA 2027-2029.

(Kryetari i këshillit, Sek.i Këshillit, Keshilltare, Anëtarët e Komisionit të ekonomisë)

- *Ky plan i aktiviteteve mund të ndryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*
- *Çdo ndryshim i tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvillimit të aktivitetit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan dhe do të jetë objekti monitorimit të performacës së Këshillit dhe do raportohetsi i tillë në fund të vitit.*
- *Këshilltarët mund të kërkojnë në çdo mbledhje Këshilli për Raprtim: Drejtori, Sektor, Zyrë në vartësi të bashkisë, por dhe jo vetëm.*
- *Plani i konsultimeve mund tën dryshojë sipas nevojave të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.*

- *Çdo ndryshim i tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvilimit të konsultimit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan.*
- *Takimet dhe konsultimet me komunitetin do të realizohen live por edhe nëpërmjet rrjeteve sociale duke lënë gjithnjë të hapur mundësinë e dhënies së mendimeve dhe vërejtjeve nga*

të interesuarit. Çdo sugjerim, koment, apo mendim protokollohet nga Sekretari i këshillit dhe prezantohet në Komisionin përkatës apo mbledhjen e Këshillit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Maliq, më 27.11.2025

PLAN I AKTIVITETEVE TE KESHILLIT BASHKIAK

(Janar-Dhjetor 2026)

Hartimi i planit të aktiviteteve synon përcaktimin e një kornize orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Maliq, duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë se këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativsi organ përfaqësues, vendimarrës,mbikëqyrës e monitorues.

Ky dokument përcakton prioritetet kryesore të politikave të punës së Këshillit të Bashkisë Maliq për vitin 2026. Me anë të këtij dokumenti anëtarët e Këshillit bien dakord të punojnësë bashku për të realizuar objektivat e përcaktura më poshte. Ky dokument bazohet në të drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Bashkisë të përcaktuara në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"I ndryshuar dhe Rregulloren e Keshillit Bashkiak Maliq.
Me synimin për të planifikuar ushtrimin sa më mire të këtyre kompetencave dhe me qëllimin e përfaqësimit të interesave të komunitetit dhe grupeve të interesit që përfaqësojnë anëtarët e këtij Këshilli:

ANGAZHOHEMI:

- Të punojmë së bashku përfuqizimin e rolit të Këshillit të Bashkisë në vendimarrje përfaqësim dhe monitorim/mbikqyrje duke bashkë qeverisur së bashku me komunitetin, duke ushtruar rolin vendimarrës, përfaqësues dhe monitorues. Për këtë qëllim:

  - Të sigurojmë transparence për vendimarrjen duke përfshirë sa më shumë pjesëtarë të komunitetit në këtë proces.
  - Të japim mundësinë çdo anëtari të komunitetit tonë që të ketë informacion mbi projekt-aktet dhe aktet të cilat miratohen si dhe të ketë mundësinë të shprehë lirshëm mendimin dhe opinionin e tij për çdo çështje që shtrohet për miratim, mbi çdo investim apo plan strategjik zhvillimor.

- Të krijojmë mundësi ndërveprimi me anëtarët e komunitetit për të përcjellë çdo shqetësim apo ankesë, për të ndërmarrë çdo iniciativë vendimarrëse për shërbimet publike që ofron bashkia.
- Të informojmë qytetarët jo vetëm mbi çështjet e detyrueshme për konsultim të cituara shprehimisht nga ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar por edhe duke bërë transparence për të ardhurat, shpenzimet dhe mënyrën e kryerjes së shërbimeve publike nga ana e Bashkisë.
- Për të qënë sa më afër komunitetit dhe për të bashkë qeverisur me ta, do përdorim mekanizmat e bashkë qeverisjes, transparences në çdo akt që do ndërmarrim, duke riorganizuar, përmirësuar edhe krijuar mekanizmat e mëposhtme:
  - Përmirësuar ndërfaqen e Këshillit të Bashkisë Maliq.
  - Publikimin e çdo projektakti ose nevoje për vendimarrjesi dhe duke nxitur reagimin qytetar me praktikat më të mira.
  - Adresuar,shqyrtuar dhe zgjidhur me seriozitet çdo ankesë, kërkesë, nismë apo peticion qytetar e cila është Brenda fushës së veprimit të pushtetit vendor.

Për këtë qëllim:

- Angazhohemi të rrisim aftësitë profesionale duke marrë pjesë në trajnime dhe zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe rritur besimin e qytetarëve në institucionin tonë.
- Pas diskutimit në grupet e punës dhe të interest biem dakord të orjentojmë punën tonë sipas planit të aktiviteteve bashkangjitur këtij dokumenti.
- Janë të mirëpritura iniciativat dhe sugjerimet nga të gjithë banorët për të bërë pjesë të këtij plani aktivitetesh çdo çështje tjetër e cila vlerësohet e rëndësishme. (hap pas hapi)

Shënim: Plan i Aktiviteteve dhe Plani i Konsultimeve Publike bashkengjitur

Muaji Janar

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
   (Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
   (Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

4. Konsultim publik me qytetarët (pyetsor online) për përcaktimin e Tavaneve Buxhetore 2027-2029.

Muaji Shkurt

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata,Kryetari i këshillit Sek.i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Konsultime publike sipas përcaktimeve ligjore.
4. Analizë e sondazhit për Tavanet Përgatitore Buxhetore për PBA 2027-2029.
(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

5. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

6. Publikimi i raportit për prioritetet e qytetare të Tavaneve Buxhetore 2027-2029.

Muaji Mars

1. Realizimii mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. Iio Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3.Analiza e realizimit të buxhetit të Keshillit Bashkiak të vitit paraardhës.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

4.Raporti për punën e këshillit të vitit paraardhës.

5. Trajnime për anetarët e këshillit bashkiak dhe të sekretarit të këshillit.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

5.Aktivitet i Aleancës së Këshilltarve Gra me rastin e 8-Marsit.

6.Raport Sektorit i Shërbimeve dhe Kujdesit Shoqëror për menaxhin e rasteve të dhunës ndaj grave.

7.Pjesëmarrjanë Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korce)

8.Miratim i Tavaneve pergatitore buxhetore per PBA 2027-2029.

Muaji Prill

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Raport mbi gjendjen e kopshteve nga ekzekutivi, ecuria e zbatimit të Planit për Arsimin Parauniversitar.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

4. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtiji nstitucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të BashkisëMaliq

(Në Këshillin e Qarkut Korçë)

Muaji Maj

1. Realizimii mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Raport për zbatimin e buxhetit e të Bashkise Maliq (4 mujor).

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

4. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtiji nstitucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

5. Ditë e hapur e KB Maliq për qyetarët.

(Kryeesia e Këshillit, Sekretari i Këshillit, Komisionet)

Muaji Qershor

1. Realizimii mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi mbledhjeve të Komisioneve të përhershme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Raport nga Sektori i Ujitje-Kullim për situatën e kanaleve Ujitës dhe vaditës në territorin e bashkisë Maliq.
4. Konsultim Publik, mbledhja e rekomandimeve për Tavanet Përgatitore Buxhetor 2027-2029 dhe për draftin e pare të PBA 2027-2029.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i drafitit të pare të Projektit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

6. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtiji nstitucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

Muaji Korrik

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara
(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Miratimi i tavaneve të PBA-së 2027-2029.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

*4.*Prezantimi i Raportit të performances për bashkinë Maliq viti 2025.

(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

5. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

Muaji Gusht

1. Realizimii mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
Në Këshillin e Qarkut Korçë)

4.Raport për gjendjen institucioneve arsimore në prag të fillimit të vitit shkollor 2025-2026.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit)

Muaji Shtator.

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata,Kryetari i këshillit Sek. i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Trajnime për komisionet e KB te keshillit.

(Sekretari i Këshillit)

4. Ceremoni për dhënie titujsh.

(Kryetari i këshillit, Kryetarët e komisioneve dhe Sekretari i Këshillit)

5. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtiji nstitucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
në Këshillin e Qarkut Korçë)

Muaji Tetor

1.Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek.i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3.Raporti mbi realizimin e të ardhurave për 8-mujorin e parë dhe zbatimin e buxhetit.

(Kryetari i Këshillit, Komisioni i Ekonomise)

4. Hartimi i planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për vitin 2027.Hartimii buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2027 hartimi i Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun për vitin 2027.

(Kryetari i Këshillit, Sekretari dhe anëtarët e Komisionit)

5. Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq
në Këshillin e Qarkut Korçë)

6. Njoftimi i Konsultimit Publik për Paketën Fiskale 2027, Buxhetin 2027, PBA 2027-2029.
(Kryetari i Këshillit, Sekr.i këshillit,
Anëtarët e Komisionit të ekonomisë)

7. Aktivite në kuadër të Tetorit rozë nga Aleanca e Këshllitareve Gra.
(Sekretari i Këshillit)

Muaji Nëntor

1. Realizimi i mbledhjes së Këshillit sipas nevojave për vendimarrje.
(Administrata,Kryetari i këshillit Sek.i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit t ëprogramuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3 Realzimi i Konsultimit Publik për Paketën Fiskale 2027, Buxhetin 2027, PBA 2027-2029.

(Kryetari i Këshillit, Sekr.i këshillit,

Anëtarët e Komisionit të ekonomisë)

4 Miratimi i planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për vitin 2027, buxhetit të Këshillit Bashkiak për vitin 2027, Planit vjetor të komunikimit dhe konsultimit me publikun për vitin 2027.
5 Pjesëmarrja në Mbledhjet e Këshillit të Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.
6 Vizitë studimore e Këshillit Bashkiak në një bashki partnere.

(Përfaqësuesit e Këshillit të BashkisëMaliq

në Këshillin e Qarkut Korçë)

Muaji Dhjetor

1. Realizimi i mbledhjve të Këshillit sipas nevojave për vendimarrje duke konsideruar dhe nevojat e fund vitit për vendimmarrje.

(Administrata, Kryetari i këshillit Sek.i Këshillit)

2. Realizimi i mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Këshillit përpara mbledhjeve të këshillit të programuara.

(Sekretari i Këshillit, anëtarët e Komisioneve).

3. Pjesëmarrjanë Mbledhjet e Këshillittë Qarkut, sipas axhendës së këtij institucioni.

(Përfaqësuesit e Këshillit të Bashkisë Maliq

në Këshillin e Qarkut Korçë)

4. Miratimi i dokumentit të PBA-se dhe buxhetit të vitit 2027..

(Kryetari i Këshillit, Sekretari i Këshillit, Komisionet)

5. Aktivitet me rastin e festive të fundvitit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ